

FJALA E DEPUTETES ERALDA BANO

E ENJTE 27 JANAR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Po të rikthehemi pas në kohë, kujtojmë se në dhjetor të vitit 2018 vendi u përfshi nga protesta, të cilat ishin të jashtëzakonshme. Asnjëherë në tridhjetë vjet demokraci nuk ishin parë protesta të atyre përmasave. Forca e jashtëzakonshme e studentëve na tregoi se sa e brishtë ishte në fakt propaganda e qeverisë përballë atyre studentëve, që me paturpësinë më të madhe përçmohen nga Erion Veliaj për faktin se jetojnë në konvikte, duke i bërë objekt krahasimi. Është vërtet turp. Erion Veliaj, një kryetar bashkie i denatruar, që nuk njeh më kufij të njerëzores, dhe të mendosh që viti 2022 është shpallur nga Europa si viti i rinisë. Për më tepër, Tirana është shpallur Kryeqyteti European i Rinisë për vitin 2022, arritje që Erion Veliaj e propagandon si arritje personale, ndërkohë që kjo arritje i takon shoqërisë civile. Ky është po i njëjti person, që në një bisedë telefonike imorale, antonimin e qytetarisë ka konviktorët. Nuk kam fjalë vërtet. Nuk kam fjalë dhe për mosreagimin e qeverisë... Por Eroni ka mësuar nga më i miri, sigurisht, sepse në vitin 2018 edhe vetë lideri suprem i quajti “ngelësa” studentët e protestave. Ku jeni ju, zonja ish-ministre e Arsimit? Ku jeni ju, që jeni përgjegjësja kryesore e shkatërrimit të sistemit universitar me atë ligjin e ndritur për arsimin e lartë. Na nxorët edhe Paktin për Universitetin, që të na hidhni hi syve, a thua se vetëm ju dini. Delir total. Pakti për Universitetin, premtime të mëdha. Fonde të hedhura pafund në letër, por asgjë nuk duket në realitet. Gjendja në konvikte vijon të jetë dëshpëruese.

Një vizitë në godinat e tyre dhe kupton fare qartë se kushtet mbeten po njësoj, ndërsa kostoja e akomodimit është shtrenjtuar. A e dini se studentët që banojnë në godinat e rehabilituara paguajnë më shumë se ata që jetojnë në godinat e vjetra, duke sjellë diskriminim në radhët e studentëve? E gjithë kjo situatë është antihumane. Kushtet duhet të jenë të njëjta për të gjithë studentët, pa bërë dallim mes tyre. Nisur nga Pakti për Universitetin, pyetja e parë dhe më logjika është: a e ka çuar buxhetin e arsimit qeveria në 5 %, sikundër ka premtuar në programin qeverisës në vitin 2013 dhe e ka ripërsëritur në vitin 2019? Fakt është se krahasuar me produktin e brendshëm bruto, fondet për sektorin e arsimit parashikohet të arrijnë në 3, 3% të produktit të brendshëm bruto, por të ardhurat që alokohen për arsimin e lartë referuar periudhës prej vitit 2018 e në vijim shkojnë vetëm në 0, 4 % të produktit të brendshëm bruto.

Sa godina janë rehabilituar sipas premtimit të qeverisë, në harkun kohor 2019 – 2021 në Tiranë dhe në rrethe ku ka konvikte studentësh? Si u shpenzuan 300 milionë leke shtesë për vitin 2019, të premtuara nga buxheti i shtetit për konviktet? Sa godina u rehabilituan dhe sa ishte numri i studentëve përfitues? Sipas parashikimeve në 2019 janë rritur, janë ulur apo janë ato kapacitete akomoduese që kanë qenë për studentët? Jemi duke diskutuar për një borxh të ri, pa një bilanc lidhur me tri fazat e para. Në përmbajtjen e marrëveshjes apo të relacionit nuk kemi asnjë gjë konkrete thjesht shifra të thata në lidhje me shumën e kredisë, pagesat që duhen kryer e të tjera, pra ka një mungesë

transparence në të tria fazat e para, shpenzimet që janë bërë, sa godina janë rikonstruktuar, sa studentë kanë përfituar, kostoja e pagesës së studentëve, kujtoj këtu që në paktin për universitetin u premtua se nëpërmjet financimit prej 16,8 milionë eurosh nga qeveria gjermane do të mundësohej rehabilitimi i një numri maksimal prej 13 ndërtesash të rezidencave studentore universitare në Tiranë. Nga 37 ndërtesa që përlllogariten të jenë në total në qytetin e Tiranës, 29 ndërtesa janë në Qytetin Studenti 1 dhe 8 në Qytetin Studenti 2, duke synuar përmirësimin e kushteve të jetesës së rreth 2900 studentëve. Ndërkaq, në vitin 2018 ministri i Energjetikës, Gjiknuri dhe kryetari i Bashkisë Tiranë premtorin që me fondin 15,5 milionë euro të Bankës Gjermane të Zhvillimit të përmirësonin kushtet e jetesës së 600 studentëve, që është larg shifrës 2900 studentë dhe shumë më larg shifrës 14 000 studentë, që janë të strehuar në konviktet e Tiranës.

Po ashtu, më 15 maj 2019, kryetari i Bashkisë së Tiranës hodhi idenë e adoptimit të konvikteve nga bizneset private, sikundër kishte ndodhur me disa prej tyre. Ende sot askush nuk e di se sa konvikte janë bërë nga privatët. Cila kompani apo biznes ka marrë përsipër rehabilitimin e këtyre godinave? Sa studentë kanë përfituar nga ky rehabilitim, nga kostoja e rehabilitimit, apo kostoja që paguajnë studentë në këto godina e të tjera? Të gjitha këto përgjigje na mungojnë. Ju kujtoj se në një raport të organizatës “Qëndresa qytetare” theksohej se 20 mijë studentë banojnë në banesa të marra me qira, pikërisht për mungesë të kapaciteteve akomoduese për ta, veçanërisht në Tiranë. Shpenzimet mujore për përballimin e qirasë nga studentët që akomodohen në banesa private përlllogariten në 2 milionë euro, të cilat dalin nga xhepat e familjeve shqiptare si një kosto shtesë për shkollimin e fëmijëve të tyre, pa shtuar këtu shpenzimet për ushqimet, energjinë, internetin dhe ujin. Që nga viti 2019, me daljen e Paktit për Universitetin, Partia Demokratike ka theksuar se me zgjidhjen e propozuar nga Kryeministri Rama kemi thjesht një arnim dhe jo një paketë ambicioze për sigurimin e kushteve bashkëkohore të jetesës dhe të studimit të studentëve. Partia Demokratike ka cituar se qeveria nuk ka ndër mend as për këtë mandat, 2017-2021, të ngrejë apo të fillojë punimet për një kampus universitar, së paku për atë të Tiranës, ku pak ditë më parë premtoi se projekti ishte gati dhe pritej vetëm financimi. Koha i dha të drejtë opozitës në atë kohë pasi ende jemi në kërkim së paku të një projekti për kampuset universitare të premtuara për më shumë se 3 vjet me radhë. Në përfundim të fjalës sime dua t’ju them se ju nuk mund të talleni me dinjitetin e studentëve, sepse ne nuk do t’ju lejojmë për një asnjë çast t’ia hidhni me poshtërsitë tuaja, sepse populli ju sheh. Faleminderit!